



In medias res

Raport për monitorimet dhe vlerësimet e bëra në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët në Kosovë (1)

konstatime dhe vlerësime për zbatimin e projektit “parandalimi i dhunës në shkolla”

Projekti “Parandalimi i dhunës në shkolla” ka për qëllim që të kontribuojë në krijimin e SHKOLLAVE JO TË DHUNSHME, duke:

- krijuar në shkolla **ambiente miqësore, humane, estetikiisht të bukura dhe tërheqëse**¹
- krijuar një **Rrjet të Fuqishëm Mbrojtës** i cili **garanton sigurinë e plotë** në relacionin shtëpi – shkollë dhe anasjelltas, në oborrin e shkollës, në shkollë, në mësonjëtoare dhe në ambiente tjera shkollore ;
- vepruar në mënyrë **proaktive- të bazuar në një planifikim strategjik pesëvjeçar** dhe me **plane konkrete, të qarta, dinamike** dhe vepruese që sigurojnë qasje të integruar dhe **holistike, kooperative e bashkëpunuese**
- insistuar në **respektimin e standardeve dhe të pritshmërive të larta të krahasueshme me vendet e Bashkësisë së Evropiane dhe të kërkesave Pedagogjisë së Paqes**
- avancuar sistemin e **qeverisjes, udhëheqjes dhe të administrimit** në institucionet arsimore
- fuqizuar **shërbimet e instruktive dhe këshillëdhënëse (pedagogjike, psikologjike, bibliotekës, mediatekës, interent-tekës, instruksionit digjital, shërbimet sociale dhe shëndetësore)**
- fuqizuar organet profesionale (këshillin e arsimtarëve, këshillat e klasave, këshillat e paraleleve, aktivet profesionale –duke u dhënë atyre rolin e departamenteve, duke formuar komisione dhe trupa profesional të fuqishëm për avancimin e fushave të ndryshme në veprimtarinë dhe në jetën e shkollave) në shkolla
- fuqizuar zhvillimin profesional të personelit mësimor –edukative dhe të stafit tjetër në shkolla
- promovuar **të drejtat e fëmijës në shkolla duke rritur pjesëmarrjen e nxënësve** në të gjitha çështjet që janë të lidhura me interesin mbizotërues të fëmijëve/duke matur për çdo vit “Temperaturën” e të Drejtave të Njeriut /Fëmijës),
- rritur dhe fuqizuar **partneritetin me komunitetin arsimor dhe me mjedisin e gjerë shkollor**, si dhe,

duke fuqizuar monitorimin dhe vlerësimin e gjendjes dhe të pamjes së ambientit shkollor, cilësisë së edukimit dhe të arsimit dhe të arritjeve të nxënësve².

Vazhdon...

¹ Studimet meta-analitike në kuadër të filozofisë së shkollave efikase, efektive dhe cilësore, që i posedojnë 11 përkatësisht 12 karakteristika lehtësisht të verifikueshme dhe të identifikueshme kanë vërtetuar se shkollat dhe institucionet arsimore që nuk janë tërheqëse, estetikiisht të bukura nxënësit e zhvillojnë vandalizmin (lexo: dhunën) dhe ulin moralin e nxënësve (lexo: keq-edukojnë)

² Gjatë zbatimit të projektit katërçipërisht kemi konstatuar se monitorimi dhe vlerësimi janë “THEMBRA E AKILIT” në arsimin e Kosovës

Përshkrimi i aktiviteteve sipas programeve

Programi i granteve për zhvillimin e shkollave

■ Gjatë muajit shtator, bashkëpunëtorët profesional të terrenit (BPT) kanë vazhduar përkrahjen e disa shkollave të vonuara të rëndit të parë për të realizuar procesin e prokurimit të projekteve të tyre, ndërsa shkollave të rëndit të parë të cilat kishin përfunduar me prokurimin e mallrave dhe shërbimeve u kanë ndihmuar për të realizuar procesin e prokurimit të mbetjeve. Si rezultat i mobilizimit të të gjithë faktorëve, është arritur që 10 shkolla të hartojnë raportin përfundimtarë. Në të njëjtën kohë BPT kanë realizuar edhe monitorimin e jashtëm të shkollave, me ç' rast kanë evidentuar suksesin e arritur dhe pengesat e shkollave të rëndit të parë në realizimin e projekteve të tyre.

■ Përveç dhënies së ndihmës shkollave të rëndit të parë, BPT kanë vazhduar me ofrimin e konsulencës së tyre shkollave të rëndit të dytë për të përgatitur Planet zhvillimore të tyre dhe projekt propozimet. Të gjitha dokumentet janë dërguar në EKP për të kontrolluar saktësinë e tyre dhe pas miratimit nga ana e EKP do të fillohet me organizimin e EKGSH-ve në të gjitha komunat.

KOSOVISION Contest

■ Kosovision Contest, që në fazat e mëhershme është përkrahur nga SDC-ja ku financuesit kryesor ishin Fondi i Lotarisë së Kantonit të Cyrihut, Fondacion Karl Popper në Zug, dhe donatorët tjerë privat. Fillimisht u zbatua nga KFOR-i, Paedgagische Hochschule

Zürich (PHZH) dhe zyra rajonale për arsim në Prizren. Nga 2008/09 gjer 2010/11, PHZH zbatoi projektin së bashku me Qendrën për Arsim të Kosovës (KEC) dhe MASHT. Projekti arriti të zgjojë interesimin e mësimit dhe të klasave të cilat morën pjesë masovikisht në projekt duke dorëzuar ide, dhe kur kishte mundësi, duke zbatuar aktivitetet nëpër komunat e tyre, siç janë zbulimet e lagjeve (oborret e shkollave, ndërtimi i oborrit shkollor), kontaktet me klasat e grupeve gjuhësore (përmes takimeve, kontakteve me letra, etj.), realizimit të revistës së shkollës, dokumentacionit rreth lagjes (aktivitetet profesionale, etj.). Duke pasur për bazë gjithë këto, SDC dhe MASHT do të vazhdojnë përkrahjen e tyre financiare edhe për tri vitet e ardhshme të projektit i cili do të implementohet nga Qendra për Arsim e Kosovës.

■ Projekti KOSOVISION CONTEST ka filluar implementimin që nga data 01.09.2011. Gjatë muajit shtator janë botuar manualët e trajnimit për mësimit, janë mbajtur takimet me drejtorët e shkollave për informim dhe po ashtu janë zhvilluar edhe trajnimet me mësimit e klasave të pesta të cilët janë pajisur me materialet e punës për fillimin e projektit. Trajnimet janë mbajtur pothuajse në të gjitha komunat e Kosovës dhe me to do të vazhdohet edhe gjatë fillimit të muajit tetor.



Parandalimi i dhunës në shkolla

■ Gjatë muajit shtator janë përgatitur raporte të detajuara për 162 shkolla. Të gjitha këto raporte janë dërguar në DKA-të përkatëse, dhe pastaj janë përcjellur tek drejtorët e shkollave. Raportet përveç pasqyrimin të gjendjes ekzistuese, përmbajnë edhe rekomandime të cilat kryesisht i drejtohen DKA-se dhe shkollës.

■ Është përgatitur dokumenti “Protokolli i veçantë për parandalimin e dhunës”. Në bashkërendim me UNICEF do të punohet në finalizimin dhe harmonizimin e tij.

Qasja Tërësektoriale në Arsim – EU EDUCATION SWAp

■ Projekti Qasja Tërësektoriale në Arsim - EU EDUCATION SWAp ka filluar të implementohet në muajin tetor të vitit 2009. Ky projekt financohet nga Komisioni Evropian dhe menaxhohet nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë. Projekti implementohet nga konsorciumi i përbërë nga Cambridge Education, Qendra për Arsim e Kosovës, Education 2000+ Consulting dhe Tribal Helm.

■ Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar një seri e trajnimeve me mësimdhënës, kryesisht të ciklit fillor. Në trajnim është prezantuar një Guidebook, material ky që i dedikohet mësimdhënësve, dhe i ndihmon atyre që të zhvillojnë aktivitetet që janë në linjë me Kornizën Kurrikulare, pra që ndihmojnë në zhvillimin e kompetencave të fëmijës.

Edukimi për Drejtësi shoqërore (EDSH)

■ Në kuadër të projektit “Edukimi për Drejtësi shoqërore”, financuar nga OSBE, gjatë muajit shtator është zhvilluar një trajnim katërditor në Gjilan. Pjesëmarrës në këtë trajnim ishin mësimdhënës nga komunitete të ndryshme që jetojnë në Kosovë. Qëllimi i trajnimit ishte që mësimdhënësit të pajisen me njohuri dhe informacione për të krijuar një klasë ku të gjithë nxënësit trajtohen të barabartë pa marrë parasysh përkatësinë e tyre (etnike, fetare, ekonomike). Trajnim ka shkuar mjaft mirë dhe pjesëmarrësit janë ndarë të kënaqur dhe janë shprehur të gatshëm që njohuritë e fituara të i zbatojnë në klasë. Programi i trajnimit është i akredituar dhe mësimdhënësit janë pajisur me certifikata.

Mbështetje e BE-së për Zbatimin e Strategjisë për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptas (EU-SIMRAES)

■ Në kuadër të projektit “Mbështetje e BE-së për Zbatimin e Strategjisë për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptas”, financuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë, gjatë këtyre muajve janë zhvilluar këto aktivitete:

■ Janë përzgjedhur 35 nxënës të shkollave të mesme të larta dhe 4 studentë të institucioneve të larta arsimore për marrjen e bursës për vitin akademik 2011/12. Do të thotë pas muajit gusht 2011, KEC e ka plotësuar këtë numër menjëherë si pasojë e përfundimit të shkollës nga 35 nxënës të ciklit të kaluar përfitues të bursave dhe 4 studentëve të ciklit të kaluar po ashtu përfitues të bursave. KEC aktualisht i jep 200 bursa për nxënës të shkollave të mesme dhe 20 bursa për studentë.

■ KEC gjatë këtij muaji i ka shpërndarë 885 pako shkollore në 5 komuna të Kosovës. (Prizren, Mitrovicë, Ferizaj, Gjakovë dhe Graçanicë). Paket shkollore kanë përmbajtur një sasi të mjaftueshme të material shkollor për tërë vitin si dhe një çantë së bashku me këtë material. Përfitues të këtyre pakove shkollore ishin fëmijët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas të komunave të lartpërmendura nga klasat 1 -9.

Përgatiti: Petrit Tahiri